



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-091

Prishtinë, më 24 qershor 2024, ora 11:20
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 QERSHOR 2024

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Enver Hoxhaj, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë të Kuvendit.

Mungoi: Saranda Bogujevci, nënkryetare e Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Abelard Tahiri, Armend Zemaj dhe Time Kadrijaj.

Mungoi: Enis Kervan, kryetar i GP Multietnik.

Në mbledhje mori pjesë edhe zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, z. Arben Loshi.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Stafi përgjegjës i Administratës së Kuvendit për mbështetje Kryesisë së Kuvendit, si dhe nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, nga grupet parlamentare dhe nga organizatat.

Mbledhjen e kryesoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me pesë (5) pika për propozimin e rendit të ditës për seancën plenare të radhës dhe me tri (3) pika për shqyrtim nga Kryesia e Kuvendit.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024,
3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024,
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 27 maj 2024

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 27 maj 2024.

2. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2024

3. Seanca plenare, e shtyrë nga data e paraparë që të mbahet më 24 maj 2024

Përsëri nuk u vendos për datën e mbajtjes së seancave të lartshënuara në pikat 2 dhe 3.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari, pas diskutimeve për rendin e ditës, të propozuar për seancë plenare, të miratuar me konsensus, vendosi që seanca e re plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 27 qershor 2024, në orën 10:00, në sallën 506 të Kuvendit, me këtë:

Rend dite

1. *Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,*
2. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
3. *Pyetjet parlamentare,*
4. *Votimi i Projektligjit nr. 08/L-309 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit për programin e parë për “Financimin e politikave zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër”, në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
5. *Votimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë,*
6. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,*
7. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-266 për gjendjen civile,*
8. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-300 për provimin e maturës shtetërore,*
9. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-296 për të huajt,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-277 për sport,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-264 për rininë*
12. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues,*

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-256 për falimentimin,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-267 për letërnjoftimin,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-274 për shërbimet private të sigurisë,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-304 për bankat,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror,
25. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti,
26. Themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për procesin e përlllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
27. Votimi i Projekt-rezolutës për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit-DASH,
28. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës për raportet e Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
29. Shqyrtimi i Projekt-rezolutës për adresimin e çështjes së emigrimit të qytetarëve nga Republika e Kosovës,
30. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për progresin mbi zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe reflektimin e Agjendës Transformuese të Kosovës në buxhet dhe politika qeveritare,
31. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028,
32. Themelimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.

Në lidhje me rendin e ditës të seancës plenare të lartshënuar, me konsensus nuk u radhit pika: Shqyrtimi i Projekt-kodit të sjelljes për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Diskutimet për këtë çështje janë dhënë në transkript.

Ndërsa për themelimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb, nga pika nr. 32 e lartshënuar, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare që në seancën plenare, më 27. 6. 2024, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre një nga komuniteti shqiptar dhe një nga komuniteti serb.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc nga pika 1 (një) e këtij përfundimi do të jetë, si në vijim:
 - GP i LVV-së, zëvendëskryetarin e parë dhe katër (4) anëtarë;
 - GP i PDK-së, dy (2) anëtarë;
 - GP i LDK-së, dy (2) anëtarë;
 - GP i AAK-së, kryetarin, dhe;
 - GP Multietnik, zëvendëskryetarin e dytë.
3. Në rast se një grup parlamentar nuk i propozon deputetët për pozitat e kryetarit ose të zëvendëskryetarëve të këtij Komisioni ad hoc, këto pozita do t'u barten grupeve tjera parlamentare, sipas radhës për këto pozita.

Në vazhdim, nënkryetari i Kuvendit, Enver Hoxhaj, e shtroi përsëri çështjen e miratimit të një rezolute për përkujtimin e viktimave të gjenocidit në Srebrenicës të Bosnjë-Hercegovinës, siç e ka miratuar Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Diskutimi i plotë i nënkryetarit z. Hoxhaj është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, kryetari deklaroi se në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit do të radhitet për seancën plenare të ardhshme, që mund të mbahet më 11 korrik 2024.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Raporti me rekomandime i Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, në lidhje me të gjeturat rreth tjetërsimit të pronës së RTP-së dhe të Fakultetit Teknik

Përsëri nuk u vendos për procedimin e mëtejshëm të raportit të lartshënuar.

2. Rekomandimi i Komisionit ad hoc për rishpalljen e konkursit për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryesia, në lidhje me Rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy pozita të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisionit të Pavarur të Mediave i dërgohet Rekomandimi me nr. 08/5529/Do-2354/2, datë 12. 6. 2024, i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar, dhe për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komuniteteve joshumicë.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kanada

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dimal Basha, Ariana Musliu-Shoshi dhe Fridon Lala, u lejohet udhëtimi zyrtar në Montreal (Kanada), prej datës 3 deri më 10 korrik 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkalim dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Kërkesa e deputetes Time Kadrijaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Time Kadrijaj, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 16 deri më 18 qershor 2024.

5. Kërkesa e deputetes Vlora Dumoshi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlora Dumoshi, i kompensohen mëditjet nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 16 deri më 18 qershor 2024.

6. Kërkesa e deputetes Time Kadrijaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Time Kadrijaj, i lejohet udhëtimi zyrtar në Petrovac (Mal të Zi), prej datës 25 deri më 27 qershor 2024.
2. Kompensimi i mëditjeve për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e akomodimi i mbulohen nga organizatori - Instituti Demokratik i Kosovës.
7. *Kërkesat e deputetëve Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Francë*

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj, u lejohet udhëtimi zyrtar në Paris (Francë), prej 28 deri më 30 qershor 2024.
2. Kompensimi i mëditjeve për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori - Aleanca e Ndërgjegjësimit të Publikut.
8. *Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për mbulimin e shpenzimeve të darkës zyrtare*

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

- Mbulohen shpenzimet në shumën prej 50,00 euro (sipas faturës), për darkën zyrtare të shtruar nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, për ambasadorin e Francës, më 16 maj 2024.
9. *Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për mbulimin e shpenzimeve nga vizita zyrtare në Norvegji*

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Saranda Bogujevci, njëherësh kryesuese e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i mbulohen shpenzimet në shumën prej 60,00 euro (sipas faturës) për blerjen

e dhuratave me produkte vendore të dhuruara në vizitën zyrtare të realizuar në Oslo (Norvegji), nga data 31 maj deri më 1 qershor 2024, sipas kërkesës nr.08/5477/Do-2420, datë 3. 6. 2024.

10. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci, për mbulimin e shpenzimeve të deputetit nga Ukraina për vizitën zyrtare në Kosovë

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e transportit në relacionin Tiranë-Prishtinë dhe Prishtinë-Tiranë, dhe të akomodimit për një natë të deputetit nga Ukraina, Yoriy Kamelchuk, për vizitën e tij zyrtare të realizuar në Kosovës, nga 6 deri më 7 qershor 2024, si dhe shpenzimet e një dreke zyrtare me Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfaqësim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

11. Kërkesa e deputetit Driton Hyseni për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi zyrtar në Bullgari

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Mbulohen shpenzimet në shumën prej 608,06 Lev - valutë bullgare (sipas faturave), për dy darka zyrtare të shtruar nga Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në udhëtimin zyrtar të realizuar në Sofje (Bullgari), prej 24 deri më 28 maj 2024.
2. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Driton Hyseni, i rimburohet shuma prej 310,00 euro për shpenzimet nga pika një (1) e këtij vendimi, sipas kërkesës nr. 08/5495/Do-2428, datë 6. 6. 2024.

12. Kërkesa e deputetes Mimoza Kusari-Lila për kompensimin e mëditjeve për një ditë shtesë në udhëtimin zyrtar në Kanada dhe në SHBA

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, i kompensohen mëditjet edhe për një (1) ditë shtesë (më 2. 6. 2024), nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Kanada dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prej 26 maj deri më 2 qershor 2024.

13. Kërkesa e deputetes Eliza Hoxha për kompensimin e mëditjeve nga udhëtimi zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Eliza Hoxha, i kompensohen mëditjet, nga udhëtimi zyrtar i realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 16 deri më 18 qershor 2024.

14. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të iftarit të shtruar nga kryetari i Kuvendit

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 280,80 euro (sipas faturës) për iftarin e shtruar nga kryetari i Kuvendit për kryetarin dhe Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, më 4 prill 2024, sipas kërkesës nr. 08/5448/Do-2414, datë 28. 5. 2024.

15. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të kryetarit të Grupit të Miqësisë Estoni-Kosovë, në vizitën zyrtare në Republikën e Kosovës

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet për dreka/darka, të transportit dhe shpenzime tjera eventuale që mund të dalin gjatë zbatimit të programit të vizitës zyrtare në Kosovë të kryetarit të Grupit të Miqësisë të Estonisë me Kosovën, Kristo Enn Vaga, që do të realizohet nga 26 deri më 28 qershor 2024.

16. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të dhuratës

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet në shumën prej 80,00 euro (sipas kuponit fiskal) për blerjen e një (1) stolie filigrani për dhuratë ish-ryeministrit të Britanisë së Madhe, Sh. T. Tony Blair, me rastin e vizitës së tij zyrtare në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës nr. 08/5550/Do-2443, datë 21. 6. 2024.

17. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, Enver Hoxhaj, për lejimin e udhëtimeve zyrtare në Francë dhe në Gjermani

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, i lejohen udhëtimet zyrtare Paris (Francë), prej 28 deri më 30 qershor 2024, dhe në Berlin (Gjermani), prej 4 deri më 7 korrik 2024.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit për në Francë dhe të akomodimit në Gjermani (4-5 korrik 2024) mbulohen nga organizatorët, ndërsa shpenzim e akomodimit në Gjermani (5-7 korrik 2024), si dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës nr. 08/5554/Do-2444, datë 21. 6. 2024.

18. Kërkesa e deputetes Blerta Deliu-Kodra për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mal të Zi

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e lartshënuara, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, i lejohet udhëtimi zyrtar në Petrovac (Mal të Zi), prej 25 deri më 27 qershor 2024.
2. Kompensimi i mëditjeve për të lartshënuarën në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e akomodimi i mbulohen nga organizatori - Instituti Demokratik i Kosovës.

Të ndryshme:

1. Shpallja e tenderit për blerjen e veturave për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, në lidhje me blerjen e veturave për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave ligjore të ligjit për prokurimin publik, të bëjë shpalljen e tenderit për blerjen e veturave për nevojat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me buxhetin e ndarë për këtë qëllim sipas këtyre kriterëve:

- 1.1. një (1) veturë – SUV (naftë); dhe
- 1.2. pesë (5) vetura - (hybrid).

2. Organizimi i ndeshjes miqësore të futbollit ndërmjet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe atyre të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me organizimin e ndeshjes miqësore të lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e akomodimit për një natë për 36 (tridhjetegjashtë) deputetë dhe staf të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me rastin e pjesëmarrjes së tyre në ndeshjen miqësore të futbollit me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila do të zhvillohet më 30 qershor 2024, në Stadiumin Kampi Nacional, Hajvali (Kosovë), si dhe shpenzimet e një dreke/darke të përbashkët me të gjithë pjesëmarrësit.

Kryetari e mbylli mbledhjen në orën 12:10 minuta.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale